



VAALIT
VAL

Zgjedhjet parlamentare 2023

Zgjedhjet parlamentare mbahen çdo katër vjet. Gjatë procesit zgjedhorë, qytetarët finlandezë do të zgjedhin 200 anëtarë të parlamentit që do të vendosin për çështjet tona të përbashkëta.

Detyrat e Parlamentit

Detyra më e rëndësishme e Parlamentit është të rregullojë ligjet sipas të cilave duhet të funksionoj shoqëria.

Detyrë tjetër e rëndësishme e parlamentit është vendosja për buxhetin e shtetit. Në buxhet përcaktohet se nga i merr paratë shteti dhe për çfarë do të përdoren paratë. Parlamenti poashtu bënë mbikëqyrjen e shpenzimeve nga paratë e shtetit. Parlamenti zgjedh kryeministrin për qeverisjen e vendit dhe bënë mbikëqyrken e veprimtarisë së qeverisë. Përveç kësaj, parlamenti vendos se çfarë mendimi duhet të ketë shteti finlandez për shumë çështje të Bashkimit Evropian.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2023 mbahen
të dielën më 2.4.2023.

Votimi paraprak në Finlandë mbahet nga data 22.-28.3.2023
ndërsa për qytetarët jashtë vendit nga data 22.-25.3.2023.

Kush mund të ndihmoj?

Nëse është e nevojshme, zyrtarët e procesit zgjedhorë do të të këshillojnë dhe do të ndihmojnë, në vendin e votimit gjatë votimit paraprak si dhe në ditën e zgjedhjeve, në të gjitha situatat.

Qendra e votimit ka edhe personin për ndihmë gjatë votimit. Mund të

kërkohet prej tij që të ndihmojë në kabinën e votimit nëse nuk je në gjendje për të plotësuar vetë fletën e votimit.

Personi për ndihmë gjatë votimit mund të jetë gjithashtu personi që e ke propozuar vetë, p.sh. një familjarë ose një i afërm i yti. Megjithatë, personi për ndihmë gjatë votimit nuk mund të jetë kandidat për zgjedhje ose në afërsi familjare me kandidatin.

Personi për ndihmë gjatë votimit nuk mund t'i tregoj askujt se për kë ke votuar.

Fshehtësia e zgjedhjeve

Secili vendos vetë, nëse dëshiron të votojë dhe për kë do të votojë.

Fshehtësia e zgjedhjeve do të thotë që ti nuk duhet për të treguar askujt për kë po voton. Për shkak të fshehtësisë së zgjedhjeve, ti e plotëson fletën e votimit në kabinën e votimit.

Kush mund të votojë?

Ti ke mundësi për të votuar në zgjedhjet parlamentare,

- **nëse ke shtetësinë e Finlandës; dhe**
- **nëse ke arritur moshën 18 vjeç jo më vonë se data 2.4.2023.**

Njoftimi për të drejtën e votimit vjen në shtëpi

Nëse ke të drejtën e votimit, një letër vjen në shtëpinë tënde. Letra përmban njoftimin për të drejtën e votës dhe informacionin për vendin tënd të votimit në ditën e zgjedhjeve. Së bashku me të poashtu vjen edhe një listë e vendeve të votimit paraprak.

Ty do të vij në postë elektronike një kartolinë njoftuese, nëse ke aktivizuar shërbimin e komunikimit elektronik, që jepet nga shërbimi për informacione dixhitale dhe të popullsisë (Digi- ja väestötietovirasto), pra portali Suomi.fi-mesazhet (më shumë informacione në www.suomi.fi/viestit). Nuk është e nevojshme të merret me vete në

vendin e votimit njoftimi për të drejtën e votës, mjafton me pasur një kartelë identifikimi.

Për kë mund të votohet?

Finlanda është e ndarë në 13 zona elektorale. Secila zonë elektorale ka kandidatët e saj. Ti ke mundësi për të votuar një person që është kandidat në zgjedhjet parlamentare në zonën tënde zgjedhore. Njësia jote zgjedhore tregohet në njoftimin për të drejtën tënde të votës.

Numrat e kandidatëve në zonën tënde zgjedhore mund të shihen në vendet e votimit dhe në kabinat e votimit. Ke mundësi për tu njoftuar me kandidatët p.sh. nga gazetatat, televizioni dhe interneti.

Votimi në shtëpi

Nëse je i sëmurë ose nëse shkuarja në vendin e votimit apo edhe votimi atje do të ishte shumë i vështirë, ti ke mundësi për të votuar në shtëpi gjatë kohës së votimit paraprak.

Për të votuar në shtëpi duhet paraprakisht për tu regjistruar deri në datën 21.3.2023 ora 16:00, në këshillin qendror zgjedhor të komunës tënde. Numri i telefonit të këshillit qendror është në njoftimin për të drejtën tënde për votim. Poashtu mund të merren më shumë informacione rreth votimit në shtëpi nga këshilli qendror zgjedhor

Kështu ti voton paraprakisht

Ke mundësi për të zgjedhur nëse dëshiron për të votuar ditën e votimit apo paraprakisht. Ke mundësi për të votuar paraprakisht në zgjedhjet parlamentare në çdo qendër votimi paraprak në Finlandë ose jashtë saj.

Për të votuar merre me vete një dokument identifikimi me foto, p.sh. pasaportën, kartelën e identifikimit ose patentën e shoferit.

- 1. Tregoja kartelën e identifikimit zyrtarit të procesit zgjedhor.** Zyrtari e kontrollon kartelën dhe të jep ty fletëvotimin.
- 2. Shko në kabinën e votimit.** Shkruaje qartë në fletëvotim numrin e

kandidatit, për të cilin po voton. Mos shkruaj asgjë tjetër në fletëvotim.

- 3. Paloje fletën e votimit në mes.**
- 4. Kthehu te zyrtari zgjedhor.** Ai do të vulosë fletën e votimit dhe do të japë një zarf për fletën e votimit, me ngjyrë kafe. Vendose fletën e votimit në zarf dhe ngjite kapakun e zarfit.
- 5. Zyrtari zgjedhor do të kërkojë nënshkrimin e formularit.** Duke nënshkruar, ti dëshmon se vetë e ke plotësuar fletëvotimin, ke marrë vulën në të dhe e ke vendosur në zarf.
- 6. Në fund, zyrtari e vendos zarfin me fletën e votimit dhe formularin** në një zarf për dërgesë postare, me ngjyrë të verdhë

Kështu ti voton në ditën e zgjedhjeve

Në ditën e zgjedhjeve, më 2.4.2023, vendet e votimit janë të hapura nga ora 9-20.

Kontrolloje se ku është vendi yt i votimit në njoftimin për të drejtën e votës. Në ditën e zgjedhjeve, ti ke mundësi për të votuar vetëm në vendin e votimit që është shënuar në njoftimin për të drejtën tënde të votimit

Merre me vete për votim një dokument identifikimi me foto, p.sh. pasaportën, kartelën e identifikimit ose patentën e shoferit.

- 1. Tregoja kartelën e identifikimit punëtorit zyrtar zgjedhor. Punëtori do të kontrollojë atë, do të gjejë emrin tënd në listën zgjedhore dhe do të japë një fletë votimi.**
- 2. Shko në kabinën e votimit. Shkruaje qartë në fletëvotim numrin e kandidatit për të cilin po voton. Mos shkruaj asgjë tjetër në fletëvotim.**
- 3. Paloje fletën e votimit në mes.**
- 4. Kthehu te zyrtari i zgjedhjeve. Ai e vulos fletën e votimit.**
- 5. Hidhe fletën tënde të votimit në kutinë e votimit.**

Voto në zgjedhjet parlamentare!

Më shumë informacione për zgjedhjet:
vaalit.fi

Poashu ke mundësi për të pyetur për zgjedhjet dhe për votimin edhe në shërbimin e ministrisë së drejtësisë në numrin 0800 9 4770.